



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË
KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

**PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETET E
VARFËRA DHE TA PAFAVORIZUARA, VITI 2026, KORÇË**

SPECIFIKIME TEKNIKE

Drejtori i DPPTMKI – Ark. Ndiçim Hoxha

Përgatiti – Ark. Edona Venxha

Ing. Theodor Kosti

Ark. Dhimitër Këri

Tabela përmbledhëse

	HYRJE
1	PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE
1.1	Mbulim çatie me tjegulla betonike
1.2	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm
1.3	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120
1.4	Veshje kornize llamarine xingat
1.5	Shtresë lluster cemento 1:2 t = 20 mm
1.6	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama
1.7	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat
1.8	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze
1.9	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama
2	PUNIME BOJATISJE
2.1	Përgatitje e vendosje lëndë e sharruar
2.2	Bojë hidroplastike e cilësisë së lartë
2.3	Bojë hidroplastike
2.4	Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm
3	PUNIME DHEU
3.1	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km
4	ANALIZA JASHTË LISTE
4.1	Hidroizolim çatie me letër hidroizoluse
4.2	Prishje tavan Koce
4.3	Heqje tjegulla ekzistuese
4.4	Heqje mbulese llamarrinë ekzistuese çati
4.5	Veshje shkallë me material druri
4.6	Ndërtim strehë druri+mbulesë kanadeze
5	PRISHJE
5.1	Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)
5.2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla
5.3	Prishje suvatim solete (h<4m)
5.4	Prishje mur guri
6	PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI
6.1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
6.2	Tavan rrjete teli + suva
6.3	Veshje me pllake majolike
6.4	Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi
6.5	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah
7	PUNIME DYER DRITARE
7.1	Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese
7.2	Dritare d/alumini dyfi xh.
7.3	F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara

7.4	Heqje dyer ekzistuese
7.5	Dyer d/alumini dopio xham
7.6	Dritare d/alumini tek xham
7.7	F.V. Vetrate d/alumini plastike me dopio xham
7.8	Dyer d/alumini tek xh.
8	PUNIME HEKUR BETONI
8.1	F.V. Konstruksione metalike te thjeshta.
9	NENSHTRESA DHE SHITESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE
9.1	Pllaka te vogla mermeri 2 cm
9.2	Shtrese me pllaka grez porcelanato
9.3	Pedane druri (binare+derrase)
10	PUNIME SHITESASH 2
10.1	Shtrese betoni C 16/20
10.2	Heqje pllaka dyschemeje
10.3	Heqje pllakash majolike
10.4	Heqje dyscheme druri (binare druri + derrase + parket)
11	PUNIME MURATURE TULLE
11.1	Mur me tulla te plota zak, deri 8m, llaç perzier M 15
11.2	Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25
11.3	Mur me tulla te plota zak, deri 12m, llaç perzier M 25
12	PUNIME BETONI DHE B/A
12.1	Breza b/a monolit C 16/20
13	INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE
13.1	F.V. Lavaman porcelani
13.2	F.V. WC allafrenga
13.3	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16
13.4	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16
13.5	F.V. Lavapjate llamarine
13.6	F.V. Bolier 12 liter, uje te ngrohje sanitar
14	PUNIME MURATURE GURI
14.1	Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25

SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, copë, ml. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

Grafiku i punimeve

Sipërmarrësi duhet ti japë Supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas të cilave, ai propozon të punohet në sit deri në mbarim të punës. Informacioni që mban Supervizori duhet të përshijë:

- Vizatime që tregojnë rregullimin e përgjithshëm të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim.
- Detaje të vendosjes së strukturave të përkohshme
- Plane të tjera që ai propozon ti adoptojë për restaurimin dhe përfundimin e të gjitha punëve.
- Detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar.
- Supervizionin e punimeve

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe sipërmarrësi duhet të riparojë çdo defekt më shpenzimet e veta, sipas projektit.

Tabelat Informuese

Sipërmarrësi duhet të vendosë dy tabela, që të përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe të vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhet shkruar në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në Shqip dhe Anglisht.

Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do ti referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara sipërmarrësit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për sipërmarrësin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate. Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktura, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohen që të aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit që do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

Kopjimi i vizatimeve (vizatimet siç është zbatuar)

Sipërmarrësi duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Sipërmarrësi do të ruajë gjithë

informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojnë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentet e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe t’i dorëzohen Supervizorit çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër. Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Sipërmarrësi gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit. Si përfundim, kopjet e riprodhuara të vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Supervizorit për aprovim. Vizatimet, “siç është zbatuar”, të aprovuara, do të bëhen pronë e punëdhënësit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Sipërmarrësi do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si edhe librezat e masave për çdo volum pune.

Dorëzimet tek Supervizori

Sipërmarrësi duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori. Sipërmarrësi duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, cetrifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto punime.

Mostrat

Sipërmarrësi duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit. Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit. Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave.

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve. Nëse materiali i propozuar për t'u zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësimin do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

Dokumenta dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguara në vizatimet, grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjithësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do t'a lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për bërjen e llogarive të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i poltë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

Fotografitë para, gjatë dhe pas procesit

Sipërmarrësi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar procesin e restaurimit përpara fillimit, procesin gjatë punës së restaurimit dhe pas përfundimit të punimeve.

Bashkëpunimi në zonë

Punimi do të bëhet në zona të kufizuara. Sipërmarrësi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- Nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësinë e kalimit për punonjësit gjatë periudhës së ndërtimit.
- Prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna.

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjitha pajisjeve të mundshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij si dhe stafin e Punëdhënësit. Në përgatitjen e programit të tij të punës, Sipërmarrësi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktorëve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

Mbojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jëtës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurit paraprak të ligjeve të aplikushme,

kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen me përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Mbrojtja e ambientit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundëshme për të siguruar që ambienti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur të ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për ti mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dizpozicion për ti kontrolluar nga Mbikëqyrësi I Punimeve në çdo kohë.

Pastrimi përfundimtarë i zones

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo llojit dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme

Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator Kompetent dhe me eksperience duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive të çdo tipi që nevojiten. Sipërmarrësi duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesat e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platform e skelës. Skeleritë duhet të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qelimin për të cilin do të përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike. Në rastet e kryerjes punimeve në anët e rrugës ku ka kalime të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masat të bëhet rrethimi i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Supervizioni

Sipërmarrësi duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperience të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe mbikëqyrjen e punës për ngritjen e skelave në kantier.

Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjetet e tjera të instalimeve ekzistuese të objektit. Metodat e prishjes së pjesëshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten. Kur prishja e ndërtesës ose e elementëve të saj nuk mund të bëhet pa problem e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementët duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktivë mbrojtës si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë. Në përgjithësi puna e shkatërrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme pa ndërhyrë në elementët bazë strukturalë. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira.

Pastrimi i kantierit

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

Prishja e pjesëve të dëmtuara

Kontraktori duhet të heqë me kujdes vetëm ato pjesë të ndërtimit të dëmtuara sipas projektit, ose struktura të tjera të drejtuar nga Supervizori. Komponentët duhen çmontuar, pastruar dhe ndarë në grumbuj. Komponentët të cilët sipas Supervizorit nuk janë të përshtatshëm për ripërdorim, duhen larguar, punë kjo që kryhet nga kontraktuesi. Materialet që janë të ripërdorshme do të mbeten në pronësi të investitorit dhe do të ruhen në vende të veçanta nga kontraktori, derisa të lëvizën prej tij deri në përfundim të kontratës.

Kontraktori, duhet të paguajë çdo dëmtim të bërë gjatë transportit të materialeve me vlerë, të rrethimeve dhe strukturave të tjera dhe nëse është e nevojshme duhet të paguajë kompensim.

Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.

Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kablllo telefonik ose elektrik.

Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për lëvizjen e kablllove.

Mbrojtja e vendit të pastruar

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

Furnizimi me ujë

Burimi kryesor i ujit në kantier do të jetë rrjeti i ujit ekzistues për çdo objekt. Në rastet kur sasite e kerkuara të ujit i tejkalojnë prurjet e rrjetit, do të perdoren burime alternative si puse apo furnizim me autobot. Para përdorimit të burimeve alternative, do të merret gjithmone miratimi i Supervizorit. Kostot e furnizimit me ujë do të merren si të mbuluara në cmimet dhe përqindjet e Kontrates.

Kushtet atmosferike dhe permbytjet

Do të merret si e mirëqenë që Kontraktori gjatë përgatitjes së ofertës së tij do të ketë marrë parasysh të gjitha kushtet e mundshme atmosferike dhe rastet e përmbytjeve në kohën e përfundimit si edhe gjatë Punimeve Permanente dhe të Përkohshme. Kontraktori nuk i takon asnjë pagesë shtesë si pasojë e ndodhjes, vazhdimësisë apo efektit të erërave të forta, borës, acarit, shirave dhe përmbytjeve, temperaturave apo lagështirës apo si pasojë e kushteve të tjera meteorologjike apo hidrologjike.

Programi i punimeve dhe punimeve të perkohshme

Duke ju referuar Ligjit Nr. 8402 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, programi i punimeve të Kontraktorit duhet të përmbajë detajet e mëposhtme:

- Radha e punimeve
- Ecurinë e planifikuar (grafiku i punës)
- Kapacitetet dhe llojet e impjanteve të propozuara
- Detajet e metodave që do të perdoren
- Detajet e punimeve të perkohshme
- Të dhëna të detajuara mbi fuqinë punëtore, të kualifikuar ose jo

Punimet do të zbatohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfundimin e njëpasnjeshëm dhe të plotë të zerave të punës. Radha e zbatimit të Punimeve do të varet nga ndryshimet e mundshme, të justifikuara, që do të behen nga Supervizori. Kantieri, duke përfshirë akomodimin e stafit dhe fuqinë punëtore dhe stafin e Supervizorit, në rast se kërkohet:

- Zyrat
- Magazinat

- Makinerite

Kontraktori nuk do të paguhet veç për kostot e mobilizimit dhe çmobilizimit, primet për garancite bankare, sigurimet, duke përfshirë dhe sigurimin e paleve të treta, shtesat, fitimet apo çfaredo lloj kostoje apo tarife tjetër, apo për punime që lidhen me sa më sipër, me përjashtim të rasteve kur çmimet për njësi për të janë përcaktuar në mënyrë specifike tek Preventivi (tabela e volumeve) apo janë identifikuar shprehimisht në Kontratë për t'u paguar.

Kantieri, ofcinat, magazinat, zyrat etj. të Kontraktorit

Kontraktori do të ndërtojë, ruajë dhe mirëmbajë një kantier për punetoret e tij së bashku me ofcinat, magazinat, zyrat, kushte higjienike dhe pajisjet e ndihmes së shpejtë.

Më përjashtim të rasteve kur në Vizatimet e projektit specifikohet ndryshe, Kantieri ka kuptimin e një trualli privat apo publik të caktuar që sipas opionit të Supervizorit është i nevojshëm apo praktik për zbatimin e Punimeve.

Kantieri dhe ndertesat e tjera do të mbahen në kushte të mira higjienike. Me përfundimin e Kontrates, të gjitha ndertesat e lehta dhe Kantier të siguruara nga Kontraktori do të hiqen pos nga Kontraktori pa asnjë kosto shtesë për Punëdhënësin dhe zona do të lihet e pastër dhe në rregull. Kontraktori nuk do të përdorë Kantierin për qëllime të tjera nga ato të Kontrates.

Nyjet Hidrosanitare

Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit, Kontraktori do t'u sigurojë punetoreve të tij nyje hidrosanitare të mjaftueshme të cilat do t'i mirëmbajë dhe pastrojë; kontraktori do të sigurohet që punetoret të mbajnë pastër kantierin dhe nyjet hidrosanitare.

Dimensionet dhe kuotat

Kontraktori duhet të verifikojë në Kantier dimensionet, distancat, kendet dhe ngritjet (mbushjet) që tregohen në Vizatimet e projektit si edhe çdo vecanti tjetër që është pjesë e Kontrates. Në rast se zbulohet ndonjë mosperputhje midis vlerave të dhëna në Vizatimet e projektit dhe atyre të Kantier të cilat mund të ndikojnë në ndonjë pjesë të Punimeve, Kontraktori duhet të njoftojë Supervizorin në kohën e duhur për t'i dhënë Supervizorit mundësi të aprovojë Vizatimet e projektit të Kontraktorit ku tregohen vlerat dhe sasitë shtesë përpara fillimit të punimeve.

Tipi i terrenit dhe Kushtet e Punes

Kontraktori duhet të përshkruajë me kushtet e përgjithshme të Kantier të Punimeve dhe të ndërtimit atje, sipërfaqen e terrenit dhe llojin materialeve që do të gërmohen, mundësinë e rënies nga terreni i butë në terren të keq dhe materialet e thyera dhe rënien e shkëmbinjve gjatë Punimeve, mundësinë e vërshimeve të permbytjeve, shkarrjeve të tokës.

Vizatimet e punes

Perpara se te fillojne punimet apo cdo pjese e tyre, Kontraktori duhet te pergatise dhe dorezoje per aprovimin e Supervizorit kopjet (ne rastin me te pare) te cfaredo Vizatimi Pune te detajuar qe mund te kerkohet per ate pjese te punes dhe ne te njejten kohe t'i terheqe vemendjen Supervizorit per diferencat qe mund te ekzistojne midis tyre dhe Vizatimeve te projektit sipas Kontrates. Supervizori, pasi Kontraktori te kete bere ndryshimet qe mund t'i kerkoje ai, do te rregjistroje ne kopjet e ndryshuara aprovimin e tij dhe do t'i ktheje nje kopje Kontraktorit qe do te zhvilloje punimet sipas ketyre ndryshimeve te aprovuara.

Kontraktori do t'i jape Supervizorit kater kopje te tjera te Vizatimeve te aprovuara te Punes. Pervec kesaj, duhet te dorrezohen edhe Vizatimet e Punes (do te ndiqet e njejta procedure qe pershkruhet me siper) ne lidhje me cdo pune qe propozohet te kryhet nga nen-kontraktoret. Aprovimi nga Supervizori i te gjitha Vizatimeve apo pjeseve te tyre nuk e çliron Kontraktorin nga pergjegjesia e kryerjes se punimeve.

Ndryshimi i Vizatimeve te projektit

Ne te gjitha rastet kur per vizatimet specifikohet apo kerkohet te dorezohen nga Kontraktori per aprovimin e Supervizorit, cdo ndryshim ne keto Vizatime qe mund te kerkohet nga Supervizori do te behet nga Kontraktori pa asnje kosto shtese.

Paraqitja e Vizatimeve te Punimeve te Paparashikuara

Kontraktori duhet t'i paraqese Supervizorit per aprovim, Vizatimet e plota te punimeve te paparshikuara qe kerkohen per kryerjen e Punimeve, se bashku me llogaritjet qe lidhen me qendrueshmerine dhe devijimet e pritshme te tyre.

Vizatimet duhet te tregojne metoden e propozuar per realizimin e zerave te ndryshem te Punimeve te Paparashikuara dhe aplikimin e tyre ne kryerjen e punimeve te Perhereshme.

Te gjitha punimet e paparshikuara duhet te projektohen sakte dhe te ndertohen, mire per te mbajtur ngarkesat per te cilat jane logaritur. Te gjitha Vizatimet dhe llogaritjet qe lidhen me to do t'i jepen Supervizorit ne kohe per t'i studjuar me kujdes dhe per te perfshire modifikimet qe mund te kerkoje Supervizori.

Pavaresisht nga aprovimi apo modifikimet qe do te behen nga Supervizori per cdo vizatim te paraqitur per cfaredo punimi te paparashikuar, ndarjet ne faza etj, Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes deri ne realizimin e ketyre punimeve, per eficiencen, sigurine dhe mirembajtjen e tyre, si edhe per te gjitha detyrimet dhe rreziqet qe lidhen me punimet e specifikuara apo te nenkuptuara ne Kontrate.

Kontraktori duhet t'i ruaje ne te njejten gjendje sa me siper, dhe ne rast aksidenti apo prishjeje qe mund te shkaktoje demtim apo plagosje, ai do te pergjigjet vete sipas dispozitave te Kushteve te Kontrates qe mund te aplikohen ne raste te demtimeve apo plagosjeve te tilla.

Dy kopje te secilit prej vizatimeve do t'i dorezohen supervizorit menjehere dhe ai do te rregjistroje ne keto kopje, te cilat jane ndryshuar dhe modifikuar sipas kerkeses, aprovimin e tij dhe do t'i ktheje nje kopje Kontraktorit i cili pastaj mund te vazhdoje ne perputhje me to. Kontraktori do t'i jape supervizorit kater kopje te tjera te vizatimeve te aprovuara.

Kostoja e plotesimit te te gjitha kerkeseve te kesaj Klauzole do te perballohet nga Kontraktori.

Rjetet ekzistuese

Kontraktori do te njihet me pozicionin e te gjitha sherbimeve ekzistuese, si linjat dhe shtyllat telefonike dhe ato te elektrikut, linjat e ujesjellesit, tubat etj, perpara se te filloje punimet per germimin, mbushjen apo ndonje pune tjeter qe mund te ndikojë ne sherbimet ekzistuese.

Kontraktori do te pergjigjet per mbarevajtjen e heqjes apo spostimit te ketyre sherbimeve sipas specifikimeve te autoriteteve perkatese, pas mareveshjes me supervizorin dhe kur kerkohet nga Punimet.

Heqja apo ndryshimi i sherbimeve ekzistuese do te jete e programuar me kohe dhe duhet te jete e hartuar ne avance per te marre aprovimin me shkrim te autoriteteve perkatese perpara fillimit te punimeve.

Kontraktori do te jete pergjegjes per demtime ne punimet apo sherbimet ekzistuese dhe do t'i kompensoje punedhenesit cfaredo kerkese te tij per kompensim ne kete drejtim.

Kujdes i vecante duhet bere per rimbushjen per kompaktimin e tokes nen tuba, kablo etj. dhe per te mos mbuluar matesat e ekspozuar te ujit dhe saracineskat.

Njoftimi per operacionet e punes

Kontraktori do te njoftoje me shkrim ne menyre te plote dhe complete Supervizorin per te gjitha veprimtarite qe ai do te ushtroje. Ky njoftim duhet te behet me kohe per t'i dhene mundesi Supervizorit te beje pergatitjet e duhura qe ai mund t'i konsiderojë si te nevojshme per inspektim apo per cfaredo qellimi tjeter. Kontraktori nuk do te filloje asnje veprimtari te rendesishme pa marre me pare aprovimin me shkrim te Supervizorit.

Gardhet e Perkohshme

Kontraktori do te marre te tera masat parandaluese dhe do te siguroje garde te perkohshme per mbrojtjen e publikut nga aksidentet qe mund te shkaktohen nga germimet, grumbuj dheu apo materiale te tjera, apo gure qe lidhen me Punimet. Kontraktori me shpenzimet e tij, menjehere pas perfundimit te cdo pjese te punes, do te sjellë tërenin në gjëndjen e mëparshme. Kontraktori eshte pergjegjes dhe do te paguaje te gjitha kostot, tarifat, demet dhe shpenzimet qe jane krijuar gjate ndonje aksidenti nga gropat dhe kanalet qe jane germuar dhe jane lene te pambrojtura apo nga materialet e lena apo te vendosura ne gjendje te pa mbrojtur apo te papershtatshme.

Hyrja ne kantierin e ndertimit

Kontraktori do te ndertoje rruge te perkohshme hyrjeje ne kantier te cilat duhet te jene ne perputhje me kushtet e sigurimit teknik. Te gjitha keto do te behen me aprovimin e Supervizorit. Kontraktori do t'i mirembaje rruget e perkohshme te hyrjes ne kushte te pershtashme per kalimin e sigurt dhe te lehte te impjanteve dhe pajisjeve derisa te mos kerkohen më per qellimet e Kontrates.

Kontraktori do te rregjistroje, duke marre aprovimin e Supervizorit, gjendjen e siperfaqeve te cdo toke private apo publike ku kalon rruga per ne kantierin e ndertimit dhe do t'i mbaje keto siperfaqe te pastra dhe normale brenda arsyes gjate zhvillimit te punimeve.

Cilesia e materialeve dhe krahut te punes

Te gjitha materialet e perfshira ne punimet e do te jene ne perputhje me klauzolat perkatese te ketyre specifikimeve. Po keshtu edhe krahut i punes duhet te jete ne perputhje me specifikimet dhe te gjitha duhet te kene aprovimin e supervizorit.

Aprovimi i Furnizueseve te materialeve dhe mallrave

Perpara se kontraktori te hyje ne nje nen-kontrate per furnizimin e materialeve apo mallrave, ai duhet te kete per kete qellim aprovimin me shkrim te supervizorit per Furnizuesin nga i cili Kontraktori propozon te marre mallrat dhe materialet. Ne rast se Supervizori ne cfaredo momenti eshte i pakenaqr me keto mallra apo materiale apo me metodat apo operacionet qe kryhen ne punimet apo vendin ku zhvillon biznesin Furnizuesi, Supervizori ka fuqine te anulloje aprovimin me shkrim qe ka bere vete me pare per kete Furnizues dhe ka te drejten te propozoje furnitore te tjere per furnizimin e atyre mallrave apo materialeve. Kontraktori ateherë do t'i marre ato mallra apo materiale nga ata furnitore dhe eshte vete pergjegjes per pagesen e kostove shtese te tyre.

Provat dhe kampionet

Pervec dispozitave te vecanta te perfshira ketu per zgjedhjen per prove dhe testimin e materialeve, Kontraktori do t'i dorezoje supervizorit, sipas kerkeses se tij, provat laboratorike te ketyre materialeve apo mallrave te cilat kontraktori propozon te perdore apo vere ne pune per punimet e tij. Keto kampione, ne rast se aprovohen, do te mbahen nga supervizori dhe asnje lloj tjeter materiali apo malli i ndryshem nga ai qe i eshte dorezuar supervizorit nuk do te perdoret per punimet e perhereshme, vetem ne rast se per keto ekzemplare Kontraktori ka aprovimin me shkrim te supervizorit. Pavaresisht nga aprovimi i supervizorit, vete Kontraktori eshte plotesisht pergjegjes per cilesine e materialeve dhe mallrave te furnizuara.

Supervizori mund te mos pranoje cfaredo materiali apo malli qe ne mendimin e tij eshte i nje cilesie me te dobet nga ajo e kampionit qe ka aprovuar me pare dhe Kontraktori do t'i heqe menjehere ato materiale apo mallra nga kantieri dhe do te siguroje mallra dhe materiale te tjera qe do te gjejne aprovimin e supervizorit me shpenzimet e tij (kontraktorit).

Kostoja e furnizimit të ketyre kampioneve dhe të sjelljes së tyre në vendin e inspektimit apo të testimit do të jetë brenda çmimeve dhe përqindjeve të tenderuara.

Në ato raste kur është specifikuar marka e prodhuesit, prodhimi i një prodhuesi tjetër do të pranohet vetëm me kusht që sipas mendimit të supervizorit ky produkt është në të gjitha aspektet i një cilësie të njëjtte apo më të lartë.

Testet

Supervizori mund të ekzaminojë dhe mund të kërkojë testimin e çdo materiali apo malli që kërkohej të përdoret për apo gjatë punimeve si ta vendosë ai vetë herë-herës dhe do të ketë akses të pakufizuar në premisat e Kontraktorit për këtë qëllim gjatë gjithë kohës.

Kontraktori do t'i sigurojë supervizorit të gjitha lehtësitë, asistencën, krahun e punës dhe pajisjet që nevojiten për ekzaminimin, testimin, peshimin apo analizimin e të gjithë ketyre materialeve apo mallrave.

Kontraktori do të përgatisë dhe sigurojë testimin e materialeve dhe mallrave me kërkesën e supervizorit.

Pavarësisht nga testet që mund të jenë bërë jashtë Kantierit, Supervizori ka të drejtë të bëjë prova të tjera të metejeshme të çfarëdo materiali apo malli në Kantier, si edhe ka të drejtën të mos pranojë ato materiale dhe mallra që nuk e kalojnë proven në Kantier.

Kostoja e plotë e të gjitha lehtësive, krahut të punës dhe pajisjeve që kërkojnë në lidhje me provat që do të bëhen në Kantier mendohen si të përfshira në përqindjet dhe cmimet e ofertes.

Programi i Kontraktorit duhet të sigurojë kohën e duhur për testimin e materialeve. Nuk do të pranohet asnjë ankese (kërkese për kompensim) për vonesa apo kosto shtesë si pasoje e sa më sipër.

Certifikatat e proves

Në rast se Supervizori nuk i ka inspektuar certifikatat e materialeve apo mallrave në vendin e prodhimit të tyre, kontraktori do të marrë certifikatat e proves nga furnitori të atyre mallrave dhe do t'ia dërgojë ato supervizorit. Këto certifikate vertetojnë që materialet dhe mallrat për të cilat bëhet fjalë janë provuar në përputhje me kërkesat e Specifikimeve dhe do të japin rezultatet e të gjitha provave të kryera.

Kontraktori do të sigurojë pajisjet/mjetet e përshtatshme për identifikimin e materialeve dhe mallrave që do të dorëzohen në kantier me certifikatat korresponduese.

Të gjitha kostot që kanë dalë në përputhje me këtë klauzolë do të konsiderohen si të përfshira në cmimet dhe përqindjet e ofertes.

Kostoja e inspektimeve eventuale te supervizorit ne vendin e prodhimit konsiderohet si e mbuluar ne Shumen e punimeve te paparashikuara.

Te gjitha materialet e furnizuar per perdorim gjate punimeve duhet te jene brenda tolerancave te specifikuara, ne cilesine e ekzemplareve te aprovuar qe do te mbahen ne zyren e supervizorit deri ne perfundim te Kontrates.

Mbrojtja e materialeve nga kushtet atmosferike

Te gjitha materialet do te magazinohen ne Kantier ne nje menyre te miratuar nga Supervizori. Kontraktori duhet te mbroje me kujdes nga kushtet atmosferike te gjitha Punimet dhe materialet qe mund te ndikohen si pasoje e tyre.

Raportimi i aksidenteve apo ngjarjeve te pazakonta

Pavaresisht nga dorezimi i raporteve te rregullta mujore mbi ecurine e punimeve, Kontraktori do t'i raportoje supervizorit menjehere dhe me shkrim, gjithcka ne lidhje me aksidentet apo ngjarje te pazakonta apo te papritura ne kantier- pavaresisht ne ndikojne ose jo ne ecurine e punes duke permendur gjithashtu edhe hapat qe ai ka ndermare apo qe po merr ne lidhje me kete ceshtje.

Punime te tjera

Gjate kohezgjatjes se kontrates, punedhenesi mund te shkaktoje kryerjen e punimeve te tjera si instalimin e sherbimeve permes apo ngjitur me Kantierin.

Kontraktori gjate gjithë kohes do te veproje ne perputhje me kerkesat e Kushteve te Pergjithshme te Kontrates ne lidhje me keto dhe me Punime te tjera te paperfshira ne Kontrate dhe do t'i lejoje aksesin permes kantierit te Punimeve sipas miratimit te Supervizorit per cdo Kontraktor tjetër apo punetore qe mund te jene duke punuar ne apo prane Kantierit.

Lidhjet me zyrtaret qeveritare dhe ata te policise

Kontraktori do te mbaje lidhje te ngushta me zyrtare te Policise dhe qeverise ne lidhje me kontrollin e trafikut dhe ceshtje te tjera, si edhe do t'u siguroje atyre per zbatimin e detyres te gjithë asistencen dhe lehtesite sipas kerkeses se tyre.

Rregulloret e ndertimit

Te gjitha ndertesat e ngritura nga Kontraktori ne kantier dhe planimetria e ndertesave dhe kantierëve duhet te jete ne perputhje me ligjet shqiptare dhe te gjitha aktet e tjera nen-ligjore ne fuqi.

Pune e kryer jo-mire

Cdo pune qe nuk perputhet me specifikimet teknike nuk do te merret parasysh/do te hidhet poshte. Kontraktori me shpenzimet e tij do te korrigjoe te gjitha defektet sipas urdherit te Supervizorit.

Tabelat lajmeruese

Kontraktori do te siguroje dhe vendose nje table ne dy hyrjet kryesore te Kantierit dhe ne zyrat e kantierit, kur kjo kerkohet nga supervizori. Kjo table, me brendashkrimet e duhura, do te perfshije titullin e projektit, emrin e punedhenesit, emrin e Institucionit financues, emrin e supervizorit dhe emrin e Kontraktorit.

Tabela me permase 2.00 x 2.50 metra duhet te miratohet me pare nga Supervizori dhe pastaj te varet.

Nuk do te kete pagese te vecante per sigurimin dhe vendosjen e te treja tabelave lajmeruese, duke qene se kostoja e tyre eshte e perfshire ne Preventiv nga Kontraktori.

Urdheri me shkrim

"Urdher me shkrim" do te thote cdo dokument apo leter e firmosur nga Supervizori dhe e derguar me poste apo qe i jepet Kontraktorit dhe ku Kontraktorit i jepen instruksione, udhezime apo drejtime ne lidhje me Kontraten.

Pavaresisht ne perdoren fjalet: miratuar, drejtuar, autorizuar, kerkuar, lejuar, urdheruar, treguar, perfshire edhe emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje te se njejtës rendesi, do te kuptohet qe shprehin miratimin, drejtimin, udhezimin, autorizimin, kerkesen, lejen, urdherin, instruksionin etj. te Supervizorit.

Karakteristikat e Materialeve

Materialet qe do te perdoren gjate punimeve duhet ti permbahen standarteve dhe rregullave nderkombetare per materialet e punimeve civile. Ne rast se nuk ka kerkesa specifike materialet duhet te jene te cilesise me te mire qe ekziston ne treg dhe qe perdoren per qelimin e caktuar. Megjithate, materialet duhet te aprovohen nga Supervizori perpara se te vihen ne perdorim.

Burimet e materialeve

Materialet do te sigurohen nga ato burime ose fabrika qe konsiderohen te pershtatshme nga Kontraktori, duke u siguruar se zbatohen rregullat e me siperme.

Ne rast se Supervizori refuzon materialet si te papershtatshme per perdorim, atehere, Kontraktori duhet ti zevendesojë ato me materiale te tjera qe i korrespondojne karakteristikave te deshiruara; materialet e refuzuara duhet te hiqen nga vendi i ndertimit nen kujdesin dhe me shpenzimet e Kontraktorit.

Megjithë aprovimin e materialeve nga Supervizori, Kontraktori mbetet përgjegjes i plote i punës së specialisteve si edhe të vete materialeve.

PUNIME BETONI DHE B/A

Betoni për kunetën është një përzierje e çimentos, agregateve të fraksionuara të rërës, agregateve të fraksionuara të zhavorrit ose gurit të thyer, ujit dhe, kur është e nevojshme, aditivëve për përmirësimin e punueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe sjelljes së betonit në kushte të veçanta atmosferike, sipas kërkesave teknike të projektit.

Përbërësit e betonit

Përbërësit e betonit duhet të përfshijnë rërë të larë, granil ose përzierje të tyre, si dhe gurë të thyer me cilësi të përshtatshme për prodhimin e betonit.

Të gjithë agregatët duhet të jenë të pastër, pa mbetje organike, pa dhe, pa argjilë dhe pa përbërës të tjerë që ndikojnë negativisht në cilësinë e betonit. Preferohet që pjesa kryesore e agregateve të ketë formë këndore dhe jo të rrumbullakët.

Materialet e përdorura për prodhimin e betonit duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës që vërteton origjinën dhe cilësinë e tyre.

Çimento

Për çdo ngarkesë çimentoje të sjellë në kantier, kontraktori duhet të paraqesë faturën e blerjes, emrin e prodhuesit dhe certifikatën përkatëse të cilësisë, në mënyrë që të vërtetohet se çimentoja është e kontrolluar dhe plotëson standardet teknike të kërkuara.

Marka e çimentos që do të përdoret duhet të jetë në përputhje me klasën e betonit të parashikuar në projekt.

Uji për beton

Uji që përdoret për prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër dhe pa substanca të dëmshme si acide, alkale, vajra, argjilë apo materiale organike.

Në përgjithësi rekomandohet përdorimi i ujit të pijshëm.

Aditivët

Aditivët mund të përdoren në raste të veçanta, kur kërkohet përmirësimi i punueshmërisë së betonit ose kur betonimi kryhet në kushte atmosferike të pafavorshme.

Në temperatura të ulëta mund të përdoren aditivë kundër ngricës, ndërsa në raste të tjera mund të përdoren shtesa për rritjen e rrjedhshmërisë ose për kontrollin e kohës së ngurtësimit, gjithmonë sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe me miratimin e supervizorit.

Depozitimi i materialeve

Materialet që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të depozitohen në mënyrë të tillë që të mbrohen nga ndotja, përzierja me materiale të papërshtatshme dhe dëmtimi i cilësisë së tyre.

Çimentoja duhet të ruhet në ambiente të thata, të mbrojtura nga lagështira, uji dhe reshjet atmosferike.

Agregatët duhet të depozitohen veçmas, mbi sipërfaqe të pastra, në mënyrë që të mos përzihen me dhe ose materiale të tjera të dëmshme.

Prodhimi i betonit

Betoni duhet të përgatitet sipas klasës së përcaktuar në projekt dhe sipas recepturës së përzierjes që siguron cilësinë e kërkuar.

Gjatë përgatitjes së betonit duhet të zbatohen rregullat teknike për dozimin, përzierjen dhe kontrollin e materialeve, në mënyrë që të arrihet një beton homogjen dhe i punueshëm.

Pas vendosjes, betoni duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të shmanget tharja e shpejtë e sipërfaqes. Gjatë periudhës së ngurtësimit ai duhet të mbrohet nga tronditjet, vibrimet, ngarkesat e parakohshme dhe çdo veprim tjetër që mund të dëmtojë cilësinë e tij.

Të gjitha sipërfaqet e pambrojtura të betonit duhet të mbahen të lagura me ujitje të vazhdueshme ose me metoda të tjera të përshtatshme për jo më pak se 7 ditë.

Pas heqjes së kallëpeve, sipërfaqet e betonit duhet të mbahen të lagura për të penguar avullimin e shpejtë të ujit nga betoni dhe për të siguruar ngurtësimin e duhur.

Hedhja e betonit

Hedhja e betonit për kunetën duhet të kryhet sipas kushteve të punës në terren dhe me mjete të përshtatshme transporti e vendosjeje.

Koha nga prodhimi i betonit deri në hedhjen e tij në vend duhet të jetë sa më e shkurtër, në mënyrë që të ruhet punueshmëria dhe cilësia e përzierjes.

Betoni nuk duhet të hidhet pa miratimin e inxhinierit ose supervizorit.

Ngjeshja e betonit është një nga proceset më të rëndësishme, pasi siguron densitetin, homogjenitetin dhe fortësinë e kërkuar. Për këtë arsye, betoni duhet të kompaktohet me kujdes, zakonisht me vibratorë, menjëherë gjatë dhe pas hedhjes.

Betoni nuk duhet të hidhet nga një lartësi më e madhe se 2 m.

Betoni duhet të vendoset në shtresa horizontale dhe të kompaktohet mirë në pozicionin përfundimtar brenda 30 minutave nga shkarkimi prej përzierësit. Në rastet kur transporti

bëhet me pajisje të posaçme që punojnë vazhdimisht, koha totale nga futja e çimentos në përzierje deri në vendosjen përfundimtare nuk duhet të kalojë 2 orë.

Kur përdoren tuba ose ulluqe për transportin e betonit, ato duhet të mbahen të pastra dhe të përdoren në mënyrë të tillë që të shmanget ndarja e përbërësve të betonit.

Uji nuk duhet të lejohet të rrjedhë ose të ushtrojë presion mbi betonin e freskët pa kaluar të paktën 48 orë nga hedhja.

Në kantier duhet të ketë pajisje të mjaftueshme për kompaktimin e betonit, përfshirë edhe pajisje rezervë në rast defekti.

Riparimi i sipërfaqeve të betonit

Çdo riparim i sipërfaqeve të betonit duhet të kryhet menjëherë pas heqjes së kallëpeve dhe brenda kohës më të shkurtër të mundshme.

Defektet sipërfaqësore, si plasaritje të vogla, vrima të izoluara ose cepa të dëmtuar, duhet të riparohen me llaç çimentoje dhe rëre me përbërje të përshtatshme dhe të ngjashme me atë të betonit ekzistues.

Riparimet duhet të kryhen me kujdes, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e sipërfaqes dhe funksionimi normal i kunetës për rrjedhjen e ujërave.

Mbrojtja dhe ngurtësimi i betonit

Betoni duhet të mbrohet nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga kushtet atmosferike dhe klimatike.

Të gjitha sipërfaqet e ekspozuara duhet të mbulohen dhe të mbahen të lagura gjatë periudhës së ngurtësimit. Për këtë mund të përdoren thasë jute të lagur, shtresa mbuluese ose metoda të tjera të përshtatshme që nuk dëmtojnë sipërfaqen e betonit.

Sipërfaqet e betonit duhet të mbahen të lagura për një periudhë jo më pak se 7 ditë. Ngurtësimi i betonit duhet të vazhdojë deri në arritjen e fortësisë së kërkuar, e cila vlerësohet plotësisht në ditën e 28-të.

Menjëherë pas kompaktimit dhe gjatë 7 ditëve të para, betoni duhet të mbrohet nga shiu, temperaturat ekstreme, ngrica, era dhe tharja e shpejtë.

Në kantier duhet të ketë materiale të mjaftueshme për mbrojtjen e plotë të betonit gjatë kësaj periudhe.

Realizimi i bashkimeve

Betonimi i kunetës duhet të kryhet pa ndërprerje, për aq sa është e mundur.

Kur ndërprerja e betonimit është e pashmangshme, duhet të merren masa të përshtatshme për realizimin e bashkimit ndërmjet dy fazave të betonimit, në mënyrë që të sigurohet lidhje e mirë dhe vazhdimësi e elementit.

Bashkimet duhet të realizohen sipas kërkesave të projektit dhe udhëzimeve të supervizorit.

Betonimi në kushte të vështira atmosferike

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit të mos kryhen në kushte të vështira atmosferike.

Ndalohet betonimi gjatë reshjeve të rrëmbyeshme, pasi uji i tepërt mund të dëmtojë përzierjen dhe të ulë cilësinë e betonit.

Në temperatura nën 4°C betonimi nuk rekomandohet. Nëse është i domosdoshëm, duhet të përdoren masa mbrojtëse dhe aditivë kundër ngricës sipas rekomandimeve të prodhuesit.

Në temperatura të larta, betoni duhet të mbrohet nga rrezet e diellit dhe nga humbja e shpejtë e lagështisë. Kjo mund të realizohet duke e mbuluar me materiale të përshtatshme dhe duke e spërkatur me ujë.

Provat e betonit

Pas prodhimit të betonit dhe para hedhjes së tij, duhet të merret kampion për kryerjen e provave laboratorike.

Këto prova duhet të verifikojnë nëse betoni plotëson kërkesat e projektit për cilësi dhe rezistencë.

Rezultatet e laboratorit duhet t'i dorëzohen supervizorit për miratim dhe kontroll.

Shtresa e betonit

Realizimi i kunetës do të kryhet me shtresë betoni të hedhur në vend, sipas përmasave dhe formës së treguar në vizatimet e projektit.

Betoni do të jetë i klasës së përcaktuar në projekt C16/20, i prodhuar në kantier ose i furnizuar nga impiant betoni, me aggregate cilësore dhe përzierje sipas standardeve teknike.

Betoni do të vendoset në shtresa të njëpasnjëshme dhe do të vibrohet mirë për të siguruar kompaktësim të plotë dhe një strukturë homogjene.

Punimet përfshijnë:

- përgatitjen e bazës së kunetës
- vendosjen e kallëpeve sipas formës së projektuar
- hedhjen dhe kompaktësimin e betonit
- përfundimin e sipërfaqes së betonit

- çdo punim tjetër të nevojshëm për realizimin e plotë të kunetës.

Përgatitja e kallëpeve

Kallëpet për formimin e kunetës mund të realizohen prej druri ose metali dhe mund të përgatiten në kantier sipas përmasave të projektit.

Sipërfaqet e kallëpeve që do të jenë në kontakt me betonin duhet të trajtohen në mënyrë që të sigurojnë:

- shkëputje të lehtë gjatë heqjes
- mosngjitjen e betonit në kallëp

Para çdo ripërdorimi, kallëpet duhet të pastrohen me kujdes për të shmangur dëmtimin e sipërfaqes së betonit.

Kallëpet duhet të jenë të vendosura dhe të fiksuara mirë në pozicionin e tyre, në mënyrë që të ruajnë formën dhe dimensionet e projektit dhe të mos lejojnë rrjedhjen e betonit gjatë hedhjes.

Gjatë betonimit nuk duhet të ndodhin deformime ose lëvizje të kallëpeve.

Para fillimit të betonimit, kallëpet duhet të jenë të pastruara nga papastërtitë, mbetjet dhe uji i tepërt.

Kontrolli dhe miratimi

Para fillimit të betonimit duhet të kryhet kontrolli i kallëpeve dhe formës së kunetës nga supervizori ose inxhinieri përgjegjës.

Betonimi nuk duhet të fillojë pa miratimin e formës së kallëpeve dhe përmasave të elementit që do të realizohet.

Heqja e kallëpeve

Kallëpet nuk duhet të hiqen përpara se betoni të ketë arritur fortësinë e mjaftueshme për të mbajtur formën e tij pa pësuar dëmtime.

Heqja e kallëpeve duhet të kryhet me kujdes për të shmangur goditjet ose dëmtimin e sipërfaqes së betonit.

Koha e heqjes së kallëpeve do të përcaktohet nga supervizori në varësi të:

- kushteve atmosferike
- temperaturës
- fortësisë së betonit.

Në kushte normale klimatike, kallëpet mund të hiqen zakonisht pas rreth 24–48 orësh, nëse betoni ka arritur fortësinë e nevojshme.

Përfundimi i sipërfaqes së betonit

Pas heqjes së kallëpeve, sipërfaqet e betonit duhet të kontrollohen për defekte të mundshme.

Çdo parregullsi e vogël sipërfaqësore mund të korrigjohet me llaç çimentoje për të arritur një përfundim të rregullt të kunetës.

Sipërfaqja e betonit duhet të përfundohet në mënyrë të tillë që të sigurojë rrjedhjen e lirë të ujit përgjatë kunetës sipas pjerrësisë së projektuar.

1. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË

1.1 Mbulim çatie me tjegulla betonike

Mbulimi i çatisë realizohet me tjegulla të tipit marselieze të cilësisë së lartë, të puthitura dhe të lidhura saktësisht me njëra-tjetrën sipas normativave teknike, duke përdorur vida/gozhdë fiksimi në pikat strategjike për mbrojtje nga era. Pjesë e zërit është edhe montimi i të gjitha aksesoreve plotësues, si rregullat e skajeve (tjegullat anësore).

Sipërfaqja përfundimtare e çatisë duhet të ketë pjerrësi uniforme, të jetë plotësisht hermetike ndaj depërtimit të ujit dhe lagështirës, si dhe e siguruar ndaj ngarkesave të erës dhe dëborës.

1.2 Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me material PVC. Ulluku me PVC me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Janë për shkarkimin e ujrave të çative dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj.

1.3 Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120

Janë për shkarkimin e ujrave të çative dhe taracave. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të çative dhe taracave prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe çatie nga 30 deri në 60 m². Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrata e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 m². Ullukët duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse, të fiksuar çdo 2 m. Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë PVC dhe e mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90 gradë.

1.4 Veshje korrnize llamarine xingat

Veshja e perimetrit të oxhakut me llamarinë të xingatuar (impjuve) do të realizohet me qëllim mbrojtjen e strehës nga agjentët atmosferikë dhe parandalimin e infiltrimeve të ujit. Fillimisht do të kryhet pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes, duke eliminuar papastërtitë. Më pas, llamarina e xingatuar do të pritët dhe formohet sipas përmasave, duke u fiksuar mekanikisht me vida inox ose të galvanizuara. Nyjet, mbivendosjet dhe pikat e kontaktit me muraturën ose elementet e tjera do të mbyllën me mastikë ose silikon hidroizolues rezistent ndaj kushteve atmosferike, duke garantuar një veshje të qëndrueshme, funksionale dhe afatgjatë. Impluvet do të jenë material llamarinë zingato 0.8mm të trashë dhe do të kapen në murin vertikal rreth 20cm dhe do të zgjaten horizontalisht rreth 25-30cm.

1.5 Shtresë lluster cemento 1:2 t = 20 mm

Përgatitjen dhe aplikimin e një shtrese lluster çimentoje me trashësi 20 mm mbi sipërfaqen e tarracës, e cila shërben si shtresë mbrojtëse dhe niveluese mbi sistemin hidroizolues, duke siguruar një bazë të fortë, të rrafshët dhe të qëndrueshme për shtresat përfundimtare të dyshemesë ose për ekspozimin e drejtpërdrejtë ndaj kushteve atmosferike, sipas projektit.

Llaçi do të përgatitet me raport 1:2 (çimento - rërë), duke përdorur çimento sipas standardeve në fuqi dhe rërë të larë, me granulometri të përshtatshme, pa përmbajtje argjile, lëndësh organike ose papastërtish të tjera që mund të ndikojnë në rezistencën dhe cilësinë e shtresës. Uji i përdorur për përgatitjen e llaçit duhet të jetë i pastër dhe i përshtatshëm për punime ndërtimore.

Përpara aplikimit të llustrës, sipërfaqja e hidroizolimit duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa dëmtime. Llustra do të aplikohet në mënyrë uniforme me trashësi 20 mm, duke respektuar pjerrësitë e projektuara për largimin e ujërave të shiut drejt pikave të kullimit. Pjerrësia duhet të jetë e vazhdueshme dhe pa kundërpjerrësi që mund të shkaktojnë grumbullim të ujit në sipërfaqen e tarracës.

Sipërfaqja do të nivelohet dhe do të përfundohet me finiturë të lëmuar duke eliminuar zgavrat, plasaritjet dhe parregullsitë. Në sipërfaqe me dimensione të mëdha duhet të realizohen fuga tkurrjeje dhe dilatimi, për të reduktuar rrezikun e plasaritjeve si pasojë e ndryshimeve termike dhe tkurrjes së materialit.

Gjatë periudhës së pjekjes, shtresa e llustrës duhet të mbrohet nga tharja e menjëhershme, rrezatimi i fortë diellor, reshjet dhe temperaturat e ulëta. Sipërfaqja duhet të mbahet e lagësht për disa ditë pas aplikimit, sipas praktikave teknike, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi normal i rezistencës mekanike dhe të shmangët formimi i plasaritjeve sipërfaqësore.

1.6 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama

Hidroizolimi i sipërfaqes do të realizohet me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama, të aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe të përgatitura paraprakisht. Shtresat do të vendosen me mbivendosje rreth 12–15 cm për të shmangur depërtimin e ujit. Në pjesët

perimetrale, hidroizolimi do të zgjatet në mënyrë vertikale, duke krijuar një barrierë të vazhdueshme kundër lagështisë dhe ujërave.

1.7 Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat

Janë për mbledhjen dhe shkarkimin e ujërave të shiut nga çatitë dhe tarracat drejt sistemit të drenazhimit. Kasetat e shkarkimit realizohen me llamarinë të xingatosur me trashësi të caktuar, me dimensione standarde për të përballuar prirjen e ujërave nga sipërfaqet përkatëse.

Kasetat duhet të montohen fort në pikat e shkarkimit të çatisë ose tarracës, me anë të mbajtëseve dhe aksesorëve fiksues të xingatosur, të cilët mbrojnë materialin nga korrozioni. Lidhjet e llamarinës duhet të jenë plotësisht të hermetizuara për të parandaluar rrjedhjen e ujit. Pjesa e poshtme e kasetës duhet të lidhet në mënyrë të sigurt me ullukun vertikal të shkarkimit, duke garantuar shkarkim të rrjedhshëm dhe pa pengesa.

1.8 Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla marseljeze

Procesi përfshin montimin e trareve mbajtës kryesorë, trareve sekondarë, duke krijuar një strukturë të ngurtë dhe të qëndrueshme dhe montimi i rrjetës së binarëve të drurit.

Mbulimi i çatisë realizohet me tjegulla të tipit marselieze të cilësisë së lartë, të puthitura dhe të lidhura saktësisht me njëra-tjetrën sipas normativave teknike, duke përdorur vida/gozhdë fiksime në pikat strategjike për mbrojtje nga era. Pjesë e zërit është edhe montimi i të gjitha aksesorëve plotësues, si rregullat e skajeve (tjegullat anësore).

Procesi i ndërtimit të çatisë kryhet sipas fazave të mëposhtme:

- Struktura mbajtëse: montimi i skeletit të drurit (trare, binarë) dhe shtrimi i dërrasave.
- Mbulimi dhe detajet: shtrimi i tjegullave marselieze dhe montimi i pjesëve fundore të kullimit.

Sipërfaqja përfundimtare e çatisë duhet të ketë pjerrësi uniforme, të jetë plotësisht hermetike ndaj depërtimit të ujit dhe lagështirës, si dhe e siguruar ndaj ngarkesave të erës dhe dëborës. Në çmim përfshihen të gjitha materialet e drurit (të trajtuara kundër kalbjes dhe insekteve), membrana izoluese, tjegullat marselieze me aksesorët e tyre, gozhdët, vidat, skelat e shërbimit, masat e sigurisë në lartësi, si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht çatinë në gjendje funksionale.

1.9 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Hidroizolimi i sipërfaqes do të realizohet me emulsion bitumi dhe një shtresë katrama, të aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe të përgatitura paraprakisht. Shtresa do të

vendosen rreth 12–15 cm për të shmangur depërtimin e ujit. Në pjesët perimetrale, hidroizolimi do të zgjatet në mënyrë vertikale, duke krijuar një barriërë të vazhdueshme kundër lagështisë dhe ujërave.

2. PUNIME BOJATISJE

2.1 Përgatitje e vendosje lëndë e sharruar

Ruhet struktura e çatisë ekzistuese duke bërë zëvendësimin e trarëve që janë të amortizuar dhe shtrimin e dyshemesë së dërrasës. Kjo dysheme do të shërbejë për vendosjen e shtresës hidroizoluese dhe për vendosjen në vend të tjegullave.

Lënda e drurit duhet të jetë e skuadruar, e trajtuar me dizinfektues ndaj krimbave kërpudhave si dhe duhet të jetë e trajtuar për rritjen e rezistencës ndaj agentëve atmosferike. Trarët, në pjesën mbështetëse të murit do të lyhen me zift. Lënda duhet të jetë e cilësisë së lartë dhe përpara se të vendosen në objekt lënda duhet të kontrollohet nga mbikëqyrësi i punimeve. Lënda e drurit e cila do të përdoret do të jetë dru i stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë.

2.2 Bojë hidroplastike e cilësisë së lartë dhe 2.3 Bojë hidroplastike

Të gjitha bojërat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzjerja e dy llojeve të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra. Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë. Lyerja bëhet me dy duar me boje në një distance kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla. Lyerja përfshin sipërfaqen e brendshme të mureve dhe tavanëve të banesës.

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavanëve kalon nëpër tre faza si më poshtë.

Lyerja me bojë hidromat e sipërfaqes:

- Në fillim bëhet përgatitja e përzjerjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzjerje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.
- Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat i holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m² sipërfaqe. Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës së mëparshme.
- Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të

vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje.

- Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2.4 Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm

Janë për mbrojtjen dhe sigurinë e lëvizjes në shkallë. Parapet e shkallëve do të realizohen me tuba inoksi në ngjyrë të verdhë ose me pamje metalizato (ose ngjyra të tjera të konkorduar me projektuesin), me lartësi përfundimtare h = 80-90 cm. Tubat duhet të jenë me profil standard (rrethor ose katror) dhe të lidhen në mënyrë të ngurtë me njeri-tjetrin përmes elementeve lidhëse dhe saldimeve të punuara pastër. Konstruksioni duhet të fiksohet fort në strukturën e shkallës me anë të pllakave bazë dhe gozhdëve ankoruese të sigurta. Të gjitha pikat e lidhjes dhe saldimit duhet të jenë të realizuara në mënyrë që të garantojnë qëndrueshmëri strukturore dhe mbrojtje ndaj korrozionit.

3. PUNIME DHEU

3.1 Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjeti i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjetet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 5 km larg nga kantieri.

4. ANALIZA JASHTË LISTE

4.1 Hidroizolim çatie me letër hidroizoluse

Hidroizolimi do të realizohet mbi sipërfaqen e dyshemesë së çatisë, përpara vendosjes së elementëve të mbulimit, duke krijuar një barrierë të vazhdueshme dhe të papërshkueshme nga uji.

Sipërfaqja ku do të aplikohet hidroizolimi duhet të jetë e pastër, e thatë, e rrafshët dhe pa pluhur, vajra, mbetje ndërtimore ose pjesë të lirshme që mund të ndikojnë në aderimin e materialit hidroizolues. Çdo parregullsi, çarje ose zgavër në sipërfaqen mbajtëse duhet të

riparohet paraprakisht, në mënyrë që shtresa hidroizoluese të mbështetet në një bazë të qëndrueshme dhe uniforme.

Materiali hidroizolues do të jetë letër hidroizoluese bituminoze ose membranë ekuivalente me karakteristika të ngjashme, rezistente ndaj lagështisë, depërtimit të ujit dhe ndryshimeve të temperaturës. Vendosja do të kryhet sipas rekomandimeve të prodhuesit, duke filluar nga pjesa më e ulët e pjerrësisë së çatisë drejt pjesës më të lartë. Fletët do të vendosen me mbivendosje gjatësore dhe tërthore jo më të vogël se 10 cm, duke siguruar vazhdimësinë e shtresës hidroizoluese në të gjithë sipërfaqen. Në zonat e mbivendosjes do të realizohet ngjitja sipas llojit të materialit, për të eliminuar mundësinë e depërtimit të ujit.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet lidhjeve me elementët konstruktivë të çatisë, skajeve, qosheve, daljeve të oxhaqeve, tubacioneve dhe çdo elementi tjetër që ndërpret vazhdimësinë e hidroizolimit. Në këto zona shtresa hidroizoluese duhet të kthehet dhe të fiksohet në mënyrë të tillë që të krijojë një izolim të pandërprerë dhe të qëndrueshëm ndaj infiltrimeve të ujit.

4.2 Prishje tavan Koce

Shpërbërja e tavaneve prej koceje në ambientet e 3 dhomave dhe korridorit, në të njëjtat ambiente ku (siç tregohet më lart) është parashikuar dhe bërja e tavaneve të rinj.

Së pari mbrohen sipërfaqet përreth (dritaret, muret etj.) dhe sigurohet largimi i instalimeve që pengojnë punën, më pas bëhet prishja me mjete manuale/mekanike.

Punimet duhet të kryhen me mjete mekanike të lehta ose manualisht, në varësi të natyrës së elementeve që do të hiqen, duke minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe dëmtimet në pjesët e ndërtesës që mbeten në përdorim. Gjatë punimeve duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e elementeve ekzistuese që nuk janë objekt prishjeje.

4.3 Heqje tjegulla ekzistuese

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla pa prekur armaturën përkatëse prej druri ose elementët e tjerë të tjerë të sistemit mbulues (zëvendësimi i trarëve të amortizuar dhe heqja e ullukëve të vjetër është parashikuar në zërat e mësipërm).

Së pari mbrohen sipërfaqet përreth (dritaret, muret etj.) dhe sigurohet largimi i instalimeve që pengojnë punën, më pas bëhet prishja me mjete manuale/mekanike.

Punimet duhet të kryhen me mjete mekanike të lehta ose manualisht, në varësi të natyrës së elementeve që do të hiqen, duke minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe dëmtimet në pjesët e ndërtesës që mbeten në përdorim. Gjatë punimeve duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e elementeve ekzistuese që nuk janë objekt prishjeje.

4.4 Heqje mbulese lllamarrinë ekzistuese çati

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me llamarinë pa prekur armaturën përkatëse prej druri ose elementët e tjerë të tjerë të sistemit mbulues (zëvendësimi i trarëve të amortizuar dhe heqja e ullukëve të vjetër është parashikuar në zërat e mësipërm).

Së pari mbrohen sipërfaqet përreth (dritaret, muret etj.) dhe sigurohet largimi i instalimeve që pengojnë punën, më pas bëhet prishja me mjete manuale/mekanike.

Punimet duhet të kryhen me mjete mekanike të lehta ose manualisht, në varësi të natyrës së elementeve që do të hiqen, duke minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe dëmtimet në pjesët e ndërtesës që mbeten në përdorim. Gjatë punimeve duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e elementeve ekzistuese që nuk janë objekt prishjeje.

4.5 Veshje shkallë me material druri

Janë për veshjen dhe dekorimin e shkallëve të brendshme, duke garantuar estetikë dhe qëndrueshmëri gjatë përdorimit. Veshja do të realizohet me material druri cilësor (balancuar dhe i tharë siç duhet), i përpunuar posaçërisht për pedanat (shkallët) dhe kundërpedanat.

Elementet e drurit duhet të jenë me trashësi të përshtatshme dhe të fiksohen fort mbi bazamentin e shkallëve me anë të ngjitësve teknikë dhe elementeve fiksuese të fshehura. Sipërfaqja e drurit duhet të trajtohet me lëndë mbrojtëse kundër lagështirës, konsumit dhe dëmtuesve, si dhe të finirohet me bojë ose llak mbrojtës (mat ose shkëlqyes). Në pjesët ballore (buzët e pedanës) duhet të realizohet punim kundër rrëshqitjes ose rreziqeve të dëmtimit.

4.6 Ndërtim strehë druri+mbulesë kanadeze

Janë për mbrojtjen nga reshjet dhe dielli, si dhe për përmirësimin estetik të ndërtesës. Konstruksioni i strehës do të realizohet me trare dhe arkitrarë druri cilësor, të tharë dhe të trajtuar paraprakisht me lëndë mbrojtëse kundër lagështirës, zjarrit, mefeve dhe dëmtuesve biologjikë.

Elementet e drurit duhet të montohen dhe të ankorohen fort në strukturën ekzistuese të ndërtesës përmes mekanizmave dhe lidhjeve metalike të xingatosura. Mbi strukturën e drurit bëhet shtrimi i dërrasave, mbi të cilin vendoset shtresa izoluese (guaina) dhe mbulesa me tulla kanadeze. Tullat kanadeze duhet të fiksohen me gozhdë të posaçme dhe të hermetizohen me ngjitës bituminoz, duke garantuar hidroizolim të plotë dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike të erërave.

5 PRISHJE

5.1 Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)

Konsiston në prishjen, shpëputjen, largimin dhe transportimin e shtresës ekzistuese hidroizoluese nga sipërfaqja e tarracës, me qëllim përgatitjen e bazës për realizimin e sistemit

të ri të hidroizolimit. Punimet përfshijnë heqjen e plotë të membranave bituminoze, letrës hidroizoluese ose materialeve të tjera hidroizoluese ekzistuese, së bashku me mbetjet e ngjitësve dhe shtresave të dëmtuara që pengojnë realizimin e një hidroizolimi të ri cilësor.

Prishja do të kryhet me mjete manuale ose mekanike të përshtatshme, duke shmangur dëmtimin e shtresës mbajtëse të tarracës, elementeve konstruktive, parapeteve, daljeve të tubacioneve, ulluqeve dhe çdo elementi tjetër të ndërtimit. Në rast se gjatë prishjes konstatohen dëmtime në shtresën bazë, ato duhet të evidentohen dhe të riparohen sipas kërkesave të projektit, përpara fillimit të punimeve të reja.

Materiali i prishur duhet të grumbullohet vazhdimisht gjatë procesit të punës, të ngarkohet, transportohet dhe të depozitohet në vendgrumbullime të miratuara për mbetje ndërtimore, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret mjedisore në fuqi. Sipërfaqja e tarracës duhet të pastrohet plotësisht nga mbetjet e hidroizolimit, pluhuri, papastërtitë dhe çdo material i lirshëm, duke krijuar një bazë të pastër dhe të përshtatshme për shtresat e reja.

Gjatë zbatimit të punimeve duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e pjesëve të objektit që nuk janë pjesë e prishjes, si dhe masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në rastet kur ekziston rreziku i depërtimit të ujit në ambientet poshtë tarracës, punimet duhet të organizohen në faza dhe sipërfaqja të mbrohet përkohësisht nga reshjet atmosferike deri në realizimin e hidroizolimit të ri.

5.2 Prishje çatie ekzistuese me tjegulla

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla të tipit marsejeze ose të tipit romana dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshtemenë ose paretet me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontalë, ulluqët vertikalë dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin dhe vënien mënjanë të tjegullave marsejeze që do të ripërdoren, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes. Heqja e tavanit të gipsit, duke përfshirë strukturën mbajtëse, suvanë dhe impiantin elektrik që mund të ekzistojë; duke përfshirë ndër të tjera skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit. Prishja e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guainës. Ky zë përfshin vetëm prishjen e çatisë që mbulon pjesën kryesore të objektit pa prekur tarracën e palestrave.

5.3 Prishje suvatim solete (h<4m)

Prishja suvasë së brendshme ekzistuese. Ky proces do të zhvillohet në të gjithë sipërfaqen e soletës. Heqja e suvasë do të bëhet me matrapik me daltë në formë spatule. Goditjet e matrapikut nuk duhen bërë në drejtimin pingul me sipërfaqen e suvasë sepse nga goditja e fortë mund të dëmtojë soletën. Të pastrohen me furçë metalike papastërtitë e suvasë në zonat me lagështirë. Prishja e një m² suva është përlogaritur të realizohet në jo më shumë

se 0.5 orë duke marrë parasysh që suvaja është me llaç çimento dhe që duhet treguar kujdes gjatë prishjes për të mos dëmtuar soletën. Rekomandohet shtimi i forcave të punës në këtë proces pasi sipërfaqja është e konsiderueshme. Të transportohen materialet, jashtë ambientit të kantierit.

5.4 Prishje mur guri

Punimi konsiston në prishjen e kontrolluar të mureve ekzistuese me gur, sipas përcaktimeve të projektit, duke përdorur mjete manuale ose mekanike të përshtatshme dhe duke garantuar ruajtjen e integritetit të elementeve konstruktive dhe instalimeve ekzistuese. Gjatë procesit të prishjes do të merren të gjitha masat e nevojshme për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e zonave përreth. Pas përfundimit të prishjes, mbetjet e materialeve do të mbledhen, largohen dhe transportohen në vendet e autorizuara për depozitim, ndërsa sipërfaqet e krijuara do të pastrohen plotësisht nga fragmente guri, llaçi dhe materialet e tjera të mbetura, duke u përgatitur për realizimin e punimeve të reja sipas projektit. Punimet do të kryhen në përputhje me kërkesat teknike dhe normativat në fuqi për objektet civile dhe publike.

6. PUNIME TAVANI DHE SUVATIME

6.1 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25

Lyerja e mureve të pastruar ose të rinj, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund lyerjes. Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s. është e nevojshme edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund stukimit. Suvatim i realizuar nga një trashësi 2cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²; rërë e larë m³ 0.005, llaç gëlqereje m-1: 2 m³ 0.03, çimento 400 kg 6.6 ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte. Suvatimi do të bëhet për të gjithë sipërfaqet e brendshme të mureve në objekt.

6.2 Tavan rrjete teli + suva

Tavan i suvatur me rrjete teli. Te gjitha sipërfaqet që do të suvatohen do të lagen më parë me ujë. Aty ku është e nevojshme ujit do ti shtohen materiale të tjera, në mënyrë që të garantohet realizimi i suvatimit më së miri. Në çdo rast kontraktori është përgjegjës i vetëm për realizimin përfundimtar të punimeve të suvatimit. Materialet e përdorura: Llaç bastard marka-25 Llaç bastard marka 1:2 Bojë hidromat.

Përshkrimi i punës: Sprucim i tavaneve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqes të muraturës duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo

detyrim tjetër për të bërë plotësisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaç bastard marka-25 me dozim per m², rërë e larë 0,005m³, llaç bastard (marka 1:2) 0,03m³, çimento (marka 400), 6,6 kg, uje i aplikuar në bazë të udhëzimevë të përgatitura në mure e tavane dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit, si dhe çdo detyrim tjetër për të bërë plotësisht suvatimin me cilësi të mirë.

Lyerje dhe lemim i sipërfaqës së suvatuar të tavanit, bëhet mbas tharjes së llaçit, për tu lyer me vonë. Lyerje e sipërfaqes me hidromat ose me gëlqere, minimumi me dy shtresa. Ngjyra duhet të jetë e bardhë dhe duhet aprovuar nga Supervizori.

6.3 Veshje me pllake majolike

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Pesha/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Grupi	Marrja e ujit (E)
I	$E < 3\%$
II a	$3\% < E < 6\%$
II b	$6\% < E < 10\%$
III	$E > 10\%$

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

Klasat e kërkesave/ngarkimit

Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	Shumë e lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	E lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës

III	E mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	Rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	Shumë e rëndë	Gastronomi, ndërtesa publike

Për muret e ambienteve me lagështirë të lartë (WC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të Klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit $< 3\%$, për të parandaluar depërtimin e ujit dhe krijimin e mykut. Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me çertifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për veshjen e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi. Veshja me pllaka porcelanat importi 60x60 cm do të bëhet për të gjithë sipërfaqen e mureve të banjës.

Punimet përmbajnë:

- Përgatitja e sipërfaqes së murit (nivelim/rafshim) dhe aplikimi i ngjitësit special të përshtatshëm për pllaka porcelanat në mure vertikale.
- Prerja e tyre duhet të kryhet me mjete të përshtatshme precize në mënyrë që vendosja në perimetër, rreth tubacioneve dhe në kënde të jetë sa më e mirë.
- Mbushja e fugave me fugolit hidroizolues pas tharjes së ngjitësit.
- Pastrim dhe larje e sipërfaqes së veshur.
- Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë.

6.4 Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi

Sprucim me llaç çimentoje të lëngët, për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m^2 : rërë e larë $0,005 m^3$; llaç gëlqereje m- 1: 2, $0,03 m^3$; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin. Suvatimi realizohet në disa shtresa:

- shtresa e parë (spërkatje)
- shtresa mbushëse
- shtresa përfundimtare

Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e rrafshët dhe pa deformime.

6.5 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah

Konsiston në realizimin e suvatimit të soletës së betonit me llaç çimentoje, të aplikuar me dorë dhe të niveluar me drejtues, për lartësi pune deri në rreth 4.0 m. Punimi përfshin të gjitha proceset e nevojshme për krijimin e një sipërfaqeje të rrafshët, të qëndrueshme dhe të gatshme për shtresat përfundimtare të patinimit dhe lyerjes.

Përpara fillimit të suvatimit, sipërfaqja e soletës do të pastrohet nga pluhuri, mbetjet e betonit, vajrat e kallëpeve dhe çdo material tjetër që pengon ngjitjen e llaçit. E gjithë sipërfaqja do të laget me ujë, ndërsa në rastet kur kërkohet përmirësimi i aderencës, do të aplikohet një shtresë spruci me llaç çimentoje të lëngët ose material lidhës i përshtatshëm, sipas udhëzimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.

Materialet e përdorura do të jenë llaç bastard Marka 25, i përgatitur me çimento, rërë të larë me granulometri të përshtatshme dhe ujë të pastër. Përzierja duhet të jetë homogjene, pa papastërti dhe me punueshmëri të përshtatshme për aplikim manual. Të gjitha materialet duhet të jenë të certifikuara dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi.

Suvatimi do të realizohet me drejtues (udhëzues nivelimi) të vendosur paraprakisht për të garantuar trashësi të njëtrajtshme dhe rrafshësi të sipërfaqes. Llaçi do të aplikohet me dorë (me krah) në një ose disa shtresa, sipas nevojës, me trashësi mesatare rreth 20 mm, duke u niveluar mbi drejtuesit dhe duke u përfunduar me mistri dhe berdaf deri në arritjen e një sipërfaqeje të lëmuar, kompakte dhe pa parregullsi. Gjatë punimeve përfshihen të gjitha skelat e shërbimit, pajisjet ndihmëse dhe çdo proces tjetër i nevojshëm për realizimin korrekt të suvatimit.

Pas përfundimit të aplikimit, sipërfaqja duhet të mbrohet nga tharja e menjëhershme, temperaturat ekstreme dhe rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor. Nëse kushtet atmosferike e kërkojnë, suvatimi duhet të mbahet i lagësht gjatë ditëve të para për të siguruar hidratimin normal të çimentos dhe për të shmangur formimin e plasaritjeve sipërfaqësore.

Kontrolli i cilësisë përfshin verifikimin e aderencës së suvës me soletën, trashësisë së shtresës, drejtësisë dhe rrafshësisë së sipërfaqes, si dhe mungesën e çarjeve, zgavrave, fryrjeve ose shkëputjeve. Sipërfaqja e përfunduar duhet të jetë e njëtrajtshme, e lëmuar dhe e gatshme për aplikimin e shtresave të patinimit dhe lyerjes, në përputhje me kërkesat e projektit dhe specifikimet teknike.

7 PUNIME DYER DRITARE

7.1 Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese

Heqje dyer dhe dritare, që realizohet, duhet të përfshijë kasën, telajot, etj., sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantierit dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier. Çmontimi i dritareve ekzistuese duhet të bëhet me kujdes për të mos dëmtuar muraturën. Vendosja e dritareve të reja sipas nivelimit dhe drejtimit korrekt. Fiksimi mekanik në strukturë me elementë të përshtatshëm. Mbushja e hapësirave ndërmjet kornizës dhe murit me shkumë poliuretani. Mbyllja përfundimtare me silikon për izolim ndaj ujit dhe ajrit. Pastrim i zonës së punimeve dhe dorëzim në gjendje funksionale.

7.2 Dritare d/alumini dyfi xham

Dritaret ekzistuese do të hiqen dhe zëvendësohen nga dritare të reja. Ngjyra e dritareve do të konkordohet me projektuesin para prodhimit të tyre. Boshllëku brenda xhamit dopio duhet të jetë 20-24mm. Sistemet e dritareve duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistence nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150km/ore). Koeficienti i konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0W (m2K). Në lidhje me izolimin e zërit, dritaret prej PVC duhet të sigurojnë izolim ndaj tingujve deri në shkallën 4 (>40dB). Ato janë të siguruara me elementë, që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit si dhe pjesët e dala që shërbejnë për hapjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i skeletit të dritares do të jetë me përmasën 95 mm e ajo do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Të dyja kornizat fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë ndërtuar me fugë ajri që shërben si thyerje termike. Panelet e xhamit (4mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të forcuara me rjetë teli).

7.3 F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara

Furnizimi dhe vendosja e dyerve, me përmasa në varësi të madhësisë së derës, përbëhen nga material tamburatë të rimesuar. Ngjyra e dyerve në objekt do të jetë e njëjtë me ngjyrën e dyerve të tjera të banesës. Ato janë të siguruar me elementë që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të derës. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i derës do të jetë me dimensione të tilla që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Të gjitha dyert duhet të jenë të pajisura me brave, çelës dhe mentesha. Dera duhet të jetë e re dhe e pa përdorur më parë.

7.4 Dyer d/alumini dopio xham dhe 7.7 Dyer d/alumini tek xh.

Dyert do të përbëhen nga:

- Një kasë periferike prej profilesh të përforcuara me profile, e cila fiksohet në mur me anë të ankerave metalike dhe elementeve të posaçme të montimit. Gjerësia e kasës do të përshtatet sipas trashësisë së murit ekzistues.
- Korniza e kanatës së derës do të realizohet me profile me shumë dhoma, të përforcuara për të garantuar ngurtësi dhe qëndrueshmëri mekanike. Trashësia dhe seksioni i profileve do të jenë sipas standardeve të prodhuesit.
- Kanata hapëse do të jetë me mbushje të plotë dhe xham, e përbërë nga panele termoizoluese me trashësi të përshtatshme, të cilat sigurojnë rezistencë ndaj lagështisë, izolim akustik dhe jetëgjatësi të lartë. Sipërfaqja do të jetë e lëmuar dhe rezistente ndaj goditjeve dhe konsumit të zakonshëm.
- Elementë të tjerë si brava, mentesha dhe doreza.

Vendosja e dyerve do të kryhet në përputhje me kushtet teknike të montimit dhe udhëzimet e prodhuesit. Kasa do të ankorohet në mur me elementë fiksues metalikë dhe hapësirat ndërmjet kasës dhe murit do të mbushen me shkumë poliuretani me densitet të lartë ose materiale të tjera të përshtatshme izoluese. Pas montimit do të kryhen rregullimet e nevojshme për të siguruar hapjen dhe mbylljen e lirë të kanatës, si dhe mbylljen hermetike të saj.

7.5 Dritare d/alumini tek xham

Dritaret ekzistuese do të hiqen dhe zëvendësohen nga dritare të reja. Ngjyra e dritareve do të konkordohet me projektuesin para prodhimit të tyre. Sistemet e dritareve duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistence nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150km/ore). Koeficienti i konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0W (m2K). Ato janë të siguruara me elementë, që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit si dhe pjesët e dala që shërbejnë për hapjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qellim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i skeletit të dritares do të jetë me përmasën 95 mm e ajo do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Të dyja kornizat fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë ndërtuar me fugë ajri që shërben si thyerje termike.

7.6 F.V. Vetratë d/alumini plastike me dopio xham

Dritaret ekzistuese do të hiqen dhe zëvendësohen nga dritare të reja të ndërtuara nga materiali PVC. Ngjyra e dritareve do të jetë sipas projektit. Boshllëku brenda xhamit dopio duhet të jetë 20-24mm. Sistemet e dritareve PVC duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistence nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150km/ore). Koeficienti i konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0W (m2K). Në lidhje me izolimin e zërit, dritaret prej PVC duhet të sigurojnë izolim ndaj tingujve deri në shkallën 4 (>40dB). Ato janë të siguruara me elementë, që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit si dhe pjesët e dala që shërbejnë për hapjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qellim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i skeletit të dritares do të jetë me përmasën 95 mm e ajo do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Të dyja kornizat fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë ndërtuar me fugë ajri që shërben si thyerje termike. Panelet e xhamit (4mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të perforuara me rjetë teli). Dritaret prej PVC mund të jenë me xham dopio (20-24mm).

8 PUNIME HEKUR BETONI

8.1 F.V. Konstrukione metalike të thjeshta.

Konstruksione të thjeshta metalike, profil metali që do të vendoset si arkitra mbi dritaret e dy dhomave. Kjo sepse elementët aktualë janë të degraduar dhe duhen zëvendësuar. Konsiston në furnizimin, transportin dhe montimin e një konstruksioni metalik mbajtës, i cili do të vendoset në nivelin e arkitrarit ekzistues mbi dritare dhe do të shërbejë si strukturë mbajtëse. Konstruksioni ka për qëllim të krijojë një sistem të qëndrueshëm mbështetës për elementët, duke siguruar transmetimin e sigurt të ngarkesave drejt elementeve ekzistuese mbajtëse të ndërtesës, pa cenuar stabilitetin e saj.

9 NENSHTRESA DHE SHITESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE

9.1 Pllaka te vogla mermeri 2 cm

Pragjet e dritareve janë dy llojesh: pragje të brendshme dhe të jashtme. Pragjet do të kenë kënde të mprehta dhe çdo detyrim tjetër për përfundimin e punës. Pragu i çdo dritareje do të ndahet në dy pjesë, një të brendshme dhe një të jashtme ku dritarja do të jetë midis tyre. Pragjet do të kenë disnivel me njëra tjetrën ku pragu i jashtëm do të jetë në 2 cm nën nivelin e atij të brendshëm. Gjithashtu pragu i jashtëm duhet të ketë një pjerrësi të vogël me pendencë drejt eksteriorit për të siguruar largimin e ujërave nga sipërfaqja e dritareve.

9.2 Shtrese me pllaka grez porcelanato

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Pesha/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6$
II b	$6 \% < E < 10$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	Shumë e lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	E lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës
III	E mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	Rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	Shumë e	Gastronomi, ndërtesa publike

Në ambientet me lagështirë (WC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të Klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %. Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

9.3 Pedane druri (binare+derrase)

Janë për krijimin e sipërfaqeve të niveluara, funksionale dhe estetike në ambiente të brendshme. Pedana do të realizohet me strukturë mbështetëse prej binarësh druri dhe shtresë përfundimtare me dërrasa druri cilësor, të tharë dhe të trajtuar.

Binarët mbështetës duhet të nivelohen saktësisht dhe të ankorohen fort mbi bazamentin e trarëve të drurit, duke ruajtur distancat teknike për ajrosjen e pjesës së poshtme. Dërrasat e drurit montohen mbi binarë me anë të vidave të fshehura ose të dukshme (inox/xingat). I gjithë materiali i drurit duhet të trajtohet paraprakisht me lëndë mbrojtëse kundër lagështirës, diellit, kalbjes dhe dëmtuesve, si dhe të lyhet me vaj ose llak mbrojtës të posaçëm për sipërfaqe që shkelen.

10 PUNIME SHITESASH 2

10.1 Shtrese betoni C 16/20

Hedhja e një shtrese betoni C16/20 në dyshtemenë e dhomës. Punimi konsiston në realizimin e një shtrese betoni të klasës C16/20, e cila do të shërbejë si bazë mbajtëse. Para hedhjes së betonit, sipërfaqja do të pastrohet dhe përgatitet në mënyrë të përshtatshme, duke siguruar një bazament të qëndrueshëm dhe kompakt. Betoni do të prodhohet dhe vendoset në përputhje me standardet teknike në fuqi duke garantuar rezistencën e kërkuar. Gjatë hedhjes do të kryhen punimet e nevojshme të nivelimit dhe vibrimit për të siguruar kompaktësi dhe homogjenitet të plotë të materialit, ndërsa pas betonimit do të merren masat e nevojshme për mirëmbajtjen dhe maturimin e tij. Punimi përfshin furnizimin me materiale, transportin, hedhjen, nivelimin dhe të gjitha proceset ndihmëse të nevojshme për realizimin e plotë të shtresës së betonit, në përputhje me normativat teknike të ndërtimit në fuqi.

10.2 Heqje pllaka dyshemeje dhe 10.3 Heqje pllakash majolike

Prisha e shtresave ekzistuese konsiston në prishjen e shtresave me pllaka ekzistuese për të përgatitur sipërfaqet për shtrimin e ri të pllakave. Së pari mbrohen sipërfaqet përreth (dritaret, muret etj.) dhe sigurohet largimi i instalimeve që pengojnë punën, më pas bëhet prishja me mjete manuale/meکانike, heqja e ngjitësit të vjetër dhe pastrimi i plotë i nënbazës nga pluhuri dhe mbetjet.

Punimet duhet të kryhen me mjete mekanike të lehta ose manualisht, në varësi të natyrës së elementeve që do të hiqen, duke minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe dëmtimet në pjesët e ndërtesës që mbeten në përdorim. Gjatë punimeve duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e elementeve ekzistuese që nuk janë objekt prishjeje.

10.4 Heqje dysHEME druri (binare druri + derrase + parket)

Janë për çmontimin dhe heqjen e plotë të shtresave ekzistuese të dysHemesë prej druri (parket, shtresë dërrasash dhe binarë mbështetës), me qëllim përgatitjen e sipërfaqes për shtresat e reja. Së pari bëhet mbrojtja e sipërfaqeve përreth (mureve, dritareve, etj.) dhe largimi i instalimeve që pengojnë punën.

Punimet duhet të kryhen me mjete mekanike të lehta ose manualisht, duke minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe duke parandaluar dëmtimet në pjesët e ndërtesës që mbeten në përdorim ose mbi strukturën mbajtëse. Pas heqjes së binarëve dhe parketit, bëhet pastrimi i plotë i nënbazës nga mbetjet e ngjitësit, pluhuri dhe mbeturinat e tjera. Të gjitha materialet e çmontuara duhet të grumbullohen dhe të transportohen jashtë kantierit në vendgrumbullimet e lejuara.

11 PUNIME MURATURE TULLE

11.1 Mur me tulla te plota zak, deri 8m, llaç perzier M 15

11.2 Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25

11.3 Mur me tulla te plota zak, deri 12m, llaç perzier M 25

Konsiston në ndërtimin e muraturës me tulla të plota të zakonshme, me lartësi deri nga 3 në 12 metra, të vendosura me llaç Marka M-25, sipas përmasave dhe detajeve të projektit. Muratura do të realizohet me tulla të pjekura, me përmasa dhe karakteristika të njëtrajtshme, pa çarje, deformime ose dëmtime, duke garantuar rezistencë të lartë mekanike dhe qëndrueshmëri në përdorim.

Materialet e përdorura do të përfshijnë tulla të plota qeramike të cilësisë së parë, llaç bastard Marka M-25, të përgatitur me çimento, gëlqere, rërë të larë me granulometri të përshtatshme dhe ujë të pastër. Llaçi duhet të jetë homogjen, me punueshmëri të mirë dhe i përgatitur në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet në fuqi.

Përpara fillimit të punimeve, baza mbi të cilën do të ndërtohet muratura duhet të jetë e pastër, e niveluar dhe me rezistencë të mjaftueshme mbajtëse. Në rastin e muraturës së katit përdhe, sipërfaqja e bazës duhet të nivelohet me një shtresë llaçi çimento 1:2, me trashësi jo më të vogël se 20 mm, për të siguruar shpërndarjen e njëtrajtshme të ngarkesave dhe pozicionimin korrekt të rreshtit të parë të tullave.

Tullat do të vendosen me fuga horizontale dhe vertikale të mbushura plotësisht me llaç, me trashësi uniforme, duke respektuar lidhjen e rregullt të rreshtave (lidhja e fugave) për të garantuar qëndrueshmërinë e murit. Gjatë ndërtimit do të realizohen të gjitha dhëmbët e lidhjes me elementët ekzistues ose me muraturat ngjitur, qoshet, kthesat, lidhjet me kolonat dhe trarët, si dhe formimi i hapjeve për dyer, dritare ose elementë të tjerë sipas projektit. Mbi hapjet do të vendosen elementët mbajtës të parashikuar në projekt, duke respektuar kërkesat konstruktive.

Gjatë punimeve duhet të kontrollohet vazhdimisht vertikaltetë, drejtësia dhe rrafshësia e muraturës me nivel, plumbçe dhe mjete të tjera matëse. Punimet do të përfshijnë të gjitha skelat e shërbimit, pajisjet ndihmëse, prerjen e tullave sipas nevojës, transportin horizontal dhe vertikal të materialeve, si dhe çdo proces tjetër të nevojshëm për realizimin e plotë të muraturës.

Muratura e përfunduar nuk duhet të paraqesë çarje, zbrazëti, deformime ose devijime nga tolerancat e lejuara dhe duhet të jetë e gatshme për aplikimin e shtresave të suvatimit ose përfundimeve të tjera të parashikuara në projekt. Të gjitha materialet dhe punimet duhet të jenë në përputhje me standardet europiane dhe specifikimet teknike në fuqi.

12 PUNIME BETONI DHE B/A

12.1 Breza b/a monolit C 16/20

Punimi “Breza b/a monolit C16/20” konsiston në realizimin e brezit monolit prej betoni të armuar sipër mureve mbajtëse të objektit, i cili do të shërbejë si element konstruktiv për lidhjen e mureve perimetrale dhe si bazë mbështetëse për montimin e konstruksionit të ri të çatisë. Brezi do të realizohet me beton të klasës C16/20, sipas dimensioneve të përcaktuara në projekt, duke përfshirë vendosjen e kallëpeve, betonimin, vibrimin mekanik për arritjen e kompaktësisë së plotë, nivelimin e sipërfaqes dhe kurimin e betonit deri në arritjen e rezistencës së projektuar. Punimet do të kryhen në përputhje me kërkesat e projektit konstruktiv dhe standardeve teknike në fuqi, duke siguruar një element monolit me rezistencë, qëndrueshmëri dhe aftësi mbajtëse të mjaftueshme për transmetimin e ngarkesave të çatisë tek muret mbajtëse. Çmimi përfshin furnizimin me beton, transportin, kallëpet, betonimin, vibrimin, kurimin, çmontimin e kallëpeve, fuqinë punëtore, mjetet e punës dhe çdo material ose proces ndihmës të nevojshëm për realizimin e plotë të brezit të

betonit të armuar. Detajet e betonit të përdorur janë dhënë më lart në seksionin e specifikimeve të përgjithshme.

13 INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE

13.1 F.V. Lavaman porcelani

Materiali i lavamanit është percaktuar si porcelan. Lavamanet duhet të sigurojnë percjellshmeri të lartë të ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbështetësit e tyre fiksohen në mur me fashetë tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllakë të murit. Pas fiksimit të saj në mur duhet të bëhet vendosja e rubinetit mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njëkohësisht lavamani duhet të pajiset edhe me piletën e tij metalike.

Permasat e lavamanit janë në varesë të llojit dhe modelit të tyre. Lavamanet vendosen në lartësi 75- 85 cm. Duke qënë se bëhet fjalë për një tualet eksiztues, lavamani do të montohet në pozicionin ku ndodhen instalimet hidrosanitare ekzistuese. Ky zë përfshin, përveç lavamanit, edhe grupin e rubinetit prej bronxi me ngjyrë të kromuar me mishelator (për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë), fleksiblat për lidhjen e lavamanit me rrjetin e ujit dhe kolonën e porcelanit e cila vendoset poshtë lavamanit dhe piletën. Lavamani duhet të jetë i ri dhe i pa përdorur më parë.

13.2 F.V. WC allafrenga

Në ambientet e tualetit parashikohet edhe vendosja e një WC-je. Ajo është me material porcelani me të dhënat e standarteve teknike. Ato janë të tipit allafrenga. WC tip allafrenga, fiksohen në dysheme ose në mur me fashetë tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllakë të murit. Para fiksimit të tyre duhet të bëhet bashkimi me tubat e shkarkimit të ujrave. WC-ja duhet të sigurojë percjellshmeri të lartë të ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi. Ky zë përfshin edhe kasetën e shkarkimit. WC-ja dhe kaseta e shkarkimit duhet të jenë të reja dhe të pa përdorura më parë.

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me ujë me anë të kasetës së shkarkimit e cila mund të instalohet direkt mbi WC ose në mur e ndarë nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i këtyre pajisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset në lartësi rreth 1,5 m lart nga dyshemeja (rasti kur është e ndarë). Ajo mund të jetë porcelani, metalike ose plastike. Duke qënë se bëhet fjalë për një tualet eksiztues, WC-ja dhe kaseta e shkarkimit do të montohen në pozicionin ku ndodhen instalimet hidrosanitare ekzistuese të tualetit.

13.3 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16

Për lidhjen e tubave të ujës-jellësit me njëri-tjetrit si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material polipropilen kopolimer (PPR), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standardit EN ISO 15874 (Kërkesat për sistemet e tubacioneve plastike për instalimet e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë).

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë të lartë ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, rezistencë të lartë ndaj presionit dhe temperaturës së ujit, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes procesit të saldimit me nxehtësi/termofuzionit).

Përmasat (diametri d=50mm) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm ose sanitar, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe presioneve të punës. Gjatë llogaritjeve të rrjetit të shpërndarjes, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret brenda normave teknike (zakonisht 1.0-2.0 m/sek), duke garantuar që presioni i punës të jetë në përputhshmëri me klasën e presionit nominal PN 10.

Diametri dhe spesori (trashësia e murit t=3.00mm) i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike të projektit. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm (d=40mm), trashësinë e murit (t=3.00mm), presionin nominal (PN 10), emrin e prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të ujës-jellësit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë me i vogël se tubi i dërgimit të ujit që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të rrjetit ose lidhjes me pjesë metalike të pajisjeve sanitare, rakorderitë e PPR (reduksionet, rakordet me fileto, etj.) duhet t'i përshtaten saktësisht secilit prej tyre.

13.4 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16

Për lidhjen e tubave të ujës-jellësit me njëri-tjetrit si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material polipropilen kopolimer (PPR), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë të lartë ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, rezistencë të lartë ndaj presionit dhe temperaturës së ujit, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes procesit të saldimit me nxehtësi/termofuzionit).

Përmasat (diametri d=20~25mm) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm ose sanitar, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe presioneve të punës. Gjatë llogaritjeve të rrjetit të shpërndarjes, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret brenda normave teknike (zakonisht 1.0-2.0 m/sek), duke garantuar që presioni i punës të jetë në përputhshmëri me klasën e presionit nominal PN 16.

Diametri dhe spesori i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike të projektit. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, trashësinë, presionin nominal (PN 16), emrin e

prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të ujësllësit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë me i vogël se tubi i dërgimit të ujit që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të rrjetit (p.sh. kalimi nga $d=25\text{mm}$ në $d=20\text{mm}$) ose lidhjes me pjesë metalike të pajisjeve sanitare, rakorderitë e PPR (reduksionet, rakordet me fileto, etj.) duhet t'i përshtaten saktësisht secilit prej tyre.

13.5 F.V. Lavapjate inoks

Ne ambientet e larjes, parashikohet lavapjata, e cila shërbejn si vende për larjen e eneve të gatimit, ushqimeve etj. Materiali i lavapjatës është inoks me një grope dhe me një hapësirë anësore për vendosjen e enëve të gatimit, pjatave etj. Lavapjatat duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Pas fiksimit të saj duhet të bëhet vendosja e rubinetave me bronx të kromuar mbi lavapjatë dhe bashkimi i lavapjatës me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njekohësisht lavapjata duhet të pajiset edhe me piletën e tij metalike.

Lavapjatat vendosen në lartësi 75- 85 cm. Duke qënë se bëhet fjalë për një ambient eksiztues, lavamani do të montohet në pozicionin ku ndodhen instalimet hidrosanitare ekzistuese. Ky zë përfshin, përveç lavamanit, edhe grupin e rubinetit prej bronxi me ngjyrë të kromuar me mishelator (për ujin e ngrohtë dhe të ftohtë), fleksiblat për lidhjen e lavamanit me rrjetin e ujit dhe piletën. Lavapjata duhet të jetë e re dhe e pa përdorur më parë.

13.6 F.V. Bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar

Boileri duhet të sigurojë një kapacitet mbajtës prej 12 litrash, izolim termik me densitet të lartë (për minimizimin e humbjeve të nxehtësisë), mbrojtje ndaj mbingarkesës termike dhe presionit të lartë, si dhe sistem efikas të ngrohjes përmes një rezistence elektrike me fuqi të përshtatshme dhe anodë magnezi për mbrojtje shtesë elektrokimike.

Boileri fiksohet poshtë lavapjatës me vida dhe kllapa mbajtëse të dimensionuara për të mbajtur peshën e pajisjes plot me ujë. Pas fiksimit të sigurt, bëhet lidhja e tij me rrjetin e furnizimit me ujë të ftohtë dhe rrjetin shpërndarës të ujit të ngrohtë përmes tubave fleksibël (fleksiblave) prej çeliku inoks. Pajisja duhet të pajiset detyrimisht me valvulën e saj të sigurisë dhe të kthimit (valvulë kundër-presionit), e cila parandalon kthimin e ujit dhe shkarkon presionin e tepërt.

Ky zë përfshin, përveç boilerit 20 litër, edhe valvulën e sigurisë, fleksiblat e lidhjes me rrjetin e ujit, materialet izoluese (teflon/fije kërpi), lidhjen me rrjetin elektrik (përfshirë spinën ose çelësin), si dhe të gjitha aksesorët e nevojshëm për fiksimin.

14 PUNIME MURATURE GURI

14.1 Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25

Konsiston në ndërtimin e muraturës me gur natyror, me lartësi deri në 3.0 m, të realizuar me llaç çimento Marka M-25, sipas dimensioneve, niveleve dhe detajeve të projektit. Muratura do të ndërtohet me gurë natyrorë të fortë, të shëndoshë, pa çarje, shtresa të dobëta ose dëmtime, me rezistencë të lartë mekanike dhe qëndrueshmëri ndaj kushteve atmosferike.

Materialet e përdorura do të përfshijnë gur natyror të përzgjedhur, llaç çimento Marka M-25, të përgatitur me çiment, rrërë të larë me granulometri të përshtatshme dhe ujë të pastër. Llaçi duhet të jetë homogjen, me punueshmëri të mirë dhe i përgatitur në përputhje me standardet teknike në fuqi. Përpara fillimit të punimeve, baza e murit duhet të jetë e pastër, e niveluar dhe me kapacitet të mjaftueshëm mbajtës. Gjatë ndërtimit, gurët do të pastrohen nga pluhuri dhe papastërtitë dhe, kur është e nevojshme, do të lagen lehtë me ujë për të përmirësuar aderencën me llaçin. Vendosja e gurëve do të realizohet në mënyrë të rregullt, duke alternuar gurët e madhësive të ndryshme për të siguruar lidhje të mirë ndërmjet rreshtave dhe shpërndarje të njëtrajtshme të ngarkesave. Gurët duhet të mbështeten plotësisht mbi shtresën e llaçit dhe fugat horizontale e vertikale duhet të mbushen plotësisht me llaç, pa krijuar zbrazëti në brendësi të murit.

Në qoshe, kryqëzime dhe në lidhjet me elementët e tjerë konstruktivë do të përdoren gurë lidhës me gjatësi të mjaftueshme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe monoliticitetin e muraturës. Faqja e murit do të ndërtohet sipas përfundimit të parashikuar në projekt, me fugatim të plotë ose të thelluar. Gjatë punimeve do të realizohen të gjitha prerjet, përshtatjet dhe lidhjet e nevojshme me elementët ekzistues të ndërtimit. Gjatë ndërtimit duhet të kontrollohet vazhdimisht vertikalisht, drejtësia dhe rrafshësia e murit me nivel dhe plumbçe. Punimet përfshijnë të gjitha skelat e shërbimit, transportin horizontal dhe vertikal të materialeve, përgatitjen e llaçit, prerjen dhe përpunimin e gurëve, si dhe çdo proces tjetër të nevojshëm për realizimin e plotë të muraturës. Muratura e përfunduar nuk duhet të paraqesë gurë të lëvizshëm, çarje, zbrazëti ose deformime dhe duhet të sigurojë rezistencë, stabilitet dhe jetëgjatësi në përputhje me kërkesat e projektit dhe standardet teknike në fuqi.

Drejtori i DPPTMKI – Ark. Ndriçim Hoxha



Përgatiti – Ark. Edona Venxha



Ing. Theodor Kosti



Ark. Dhimitër Këri

